



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 8 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve si dhe me aktin nr. 503/4 prot., datë 21.02.2024, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në lidhje me kërkesën tuaj të parë, lidhur me përshpejtimin e çështjeve pranë gjykatave të apelit, risjellim në vëmendjen tuaj se, me shkresën nr. 503/3 prot., datë 15.02.2024, ju është sqaruar se në rastet kur Kodi i Procedurës Civile apo një ligj i veçantë nuk ka përcaktuar afat për gjykimin e çështjes, kjo e fundit mund të përshpejtohet vetëm mbi kërkesë të palëve, për shkak të natyrës dhe kategorisë specifike të çështjes ose për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, sipas parashikimeve të vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”. Pra, gjyqtari relator nuk mund t’i japë përparësi një çështjeje gjyqësore pa u paraqitur më parë një kërkesë me shkrim për përshpejtim nga palët, edhe nëse kjo çështje përfshihet në kategoritë e çështjeve të cilat sipas natyrës së tyre specifike ky vendim ka parashikuar mundësinë e përshpejtimin të tyre. Kjo pasi, çdo kërkesë do të vlerësohet eventualisht rast pas rasti nga gjyqtari relator, i cili në përfundim mund t’a vlerësojë atë si të bazuar ose jo. Për ta përmbledhur dhënia e përparësisë në gjykim në bazë të vendimit nr. 78, të sipërcituar, përmban një procedurë të caktuar për t’u ndjekur nga pala e interesuar, në konkluzion të së cilës vlerësohet nga ana e gjyqtarit relator nëse është e bazuar ose jo.

Ndërsa, në lidhje me kërkesën tuaj të dytë, Këshilli ju ka vënë në dispozicion linkun e vendimeve të arsyetuara për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë të 3 anëtarëve të kërkuar nga ju, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe i anonimizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vendimi i arsyetuar përmban një përshkrim të detajuar të të gjithë procedurës së përzgjedhjes të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, duke përfshirë kuadrin ligjor dhe nënligjor në të cilin është bazuar; relatori i caktuar; informacion mbi procedurën e verifikimit të plotësimin të kriterëve të kandidimit nga kandidatët, procedurat e përzgjedhjes apo mbi dokumentacionin e administruar në kuadër të kësaj procedure.

Sjellim në vëmendjen tuaj se, në çdo procedurë për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, legjislacioni në fuqi, e më konkretisht neni 32 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon marrjen e informacioneve nga disa institucione kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës të subjekteve. Konkretisht, kërkohen ndër të tjera informacione nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, apo dhe shërbimet shtetërore informative, etj. Me shkresën nr. 503/3 prot., datë 15.02.2024 ju kemi sqaruar lidhur me detyrimin ligjor mbi kufizimin e aksesit në këto informacione, një qëndrim ky i mbajtur jo vetëm në këtë rast por edhe për kërkesa të tjera të ngjashme.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!